



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 442/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Laziq dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Valon Ramadani nga subjekti politik Nisma për Kosovën, dega në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me dt. 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

- I. **Miratohet** si e bazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Valon Ramadani nga subjekti politik Nisma për Kosovën, dega në Ferizaj,
- II. **Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ti rinumëroi vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektit politik Nisma në Vendvotimin (VV) 2505D/05R.
- III. **Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit të VV si në pikën -II- të këtij diapozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga Valon Ramadanin kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e subjekti politik Nisma dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se në VV nr: 2505D/05R kishte (pasur 10 vota), ndërsa kryesuesi nuk iu ka shënuar votat e tij.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar deklaratën e vëzhgueses Blerta Sejdiu të VV nr: 2505D0/05R.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “*Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme* “

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

ankesa është e bazuar

PZAP-i, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati Valon Ramadani nga subjekti politik Nisma në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon në ankesën e tij se është dëmtuar nga mos procedimi i 10 votave në FRK nga ana e Kryesuesit të VV nr: 2505D/05R.

Nga ekipi i PZAP-it, është konstatuar se kutia e votimit me nr. 2505D/05R për Komunën e Ferizajit, ishte e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shiriti në mes të kutisë. Shiritat anësor të kutisë kanë nr. 113870, 107955, 107954 dhe 107953 ndërsa shiriti i mesëm nr. 107951 i cili nuk ishte i prekur fare. Shiriti i thesit brenda kutisë së votimit mban numrin nr.107952.

Në vazhden e hetimit, ekipi i PZAP-it, ka konstatuar se nga origjinali i FRK-së, që gjendet në QNR, kandidati me nr 55 nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, nuk posedon asnjë votë, ndërsa pas numërimit të fletëvotimeve lidhur me kandidatin në fjalë rezultojnë se i njëjti i posedon (12 vota në kutinë e votimit) nr: 2505D/05R .

Pas përfundimit të hetimit thesi brenda kutisë ishte mbyllur me shiritin e sigurisë me nr. 0010607 dhe mbyllja e kutisë me shirita të sigurisë si 030559, 030558, 030557 dhe 030556.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe nga deklaratat e vëzhguesit se kandidati me nr 55 ka poseduar 10 vota dhe nga hetimet e bëra del se ka pasur një lëshim gjatë plotësimit të FRK-së në VV e cekur më lartë, me ç'rast numri i 10 votave të kandidatit Valon Ramadani nuk ishin përfshirë në rezultatet përfundimtare të shpallura nga ana e KQZ-së

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura është vendosur si në dispozitiv në bazë të nenit 115.1,117.4 të LZP-së, dhe nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 442/2014 më datën 30.06.2014



**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*